




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

14 Nr. 812/23

Dt. 11.08.2023

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “Albkos Safety” sh.p.k. me seli në Fushë Kosovë, kundër Njoftimit për Kontratë të dt. 24.07.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik, më datën 11.08.2023 bie këtë:

V E N D I M

- 1. Aprovohet** pjesërisht si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim e datës 10.08.2023, e subjektit në procedurë : “Albkos Safety” sh.p.k. me seli në Fushë Kosovë, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit, Njoftim për Kontratë të Autoritetit Kontraktues të datës 24.08.2023 lidhur me Specifikat Teknike të saktësuar në Dosjen e Tenderit në aktivitetin e prokurimit : “Furnizimi me pajisje dhe mjete për zjarrfikëse” me nr. të prokurimit : VU644 – 23 – 7665 – 121 dhe Nr. i brendshëm : VU644 – 23 – 087 – 121
- 2.** Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik do të ndër marr veprimet procedurale për korrigjimin dhe harmonizimin e Specifikave Teknike, në pajtim me këtë vendim dhe në pajtim me korrigjimet e bëra nga Njësia Kërkuese e A.K.
- 3.** Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit : “Furnizimi me pajisje dhe mjete për zjarrfikëse” me nr. të prokurimit : VU644 – 23 – 7665 – 121 dhe Nr. i brendshëm : VU644 – 23 – 087 – 121

Në Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të A.K., e parashtruar nga Op. Ek.- Ankuesi, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjore, Op. Ek. konsideron se Kërkesa e saktësuar në Specifikat Teknike shkelin nenin 1 – Qëllimi, nenin 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, nenin 7- Barazia në Trajtim/J-Diskriminimi, nenin 28 – Specifikimet Teknike, nenin 53 – Sigurimi i informatave për kandidatët dhe të interesuarit dhe nenin 96 të Rregullores për Prokurimin Publik 01.11.2022, sepse, sikurse pretendon Ankuesi Kërkesat e saktësuar në Specifikat Teknike të Dosjes së Tenderit, lidhur me pajisjet dhe mjetet në fjalë nuk janë në pajtim me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe si e tillë paraqet kufizim të pjesëmarrjes së O.E. në aktivitetin e prokurimit në fjalë, me çka sikurse konsideron Ankuesi Parashtruesi i Kërkesës për Rishqyrtim, janë shkelur dispozitat e LPP-së të cituara si më lartë në këtë Vendim.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Op. Ek. të dhëna në Kërkesën për Rishqyrtim, duke marrë për bazë dhe rekomandimin e Njësies kërkuese të Autoritetit Kontraktues, lidhur me korrigjimin e Specifikave Teknike, A.K. konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e Op. Ek. është pjesërisht e bazuar, për arsye se Autoriteti Kontraktues, Specifikat Teknike për pajisjet dhe mjetet në fjalë do ti korrigjoi dhe përshtatë në harmoni me natyrën e aktivitetit të prokurimit, respektivisht me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, ashtu që të jenë gjithëpërfshirëse, jo kufizuese dhe që i japin hapësirë dhe mundësi O.E. të interesuar të

marrin pjesë dhe të mundë ti përmbushin sa më lehtë Kërkesat e A.K. të saktësuara në Specifikat Teknike të pajisjeve dhe mjeteve për zjarrfikëse, sa më mirë dhe sa më lehtë, pa u rrezikuar qëllimi i aktivitetit dhe funksionaliteti i mjeteve dhe pajisjeve që janë lëndë e këtij aktiviteti të prokurimit.

Zgjidhjet e ndërmarra nga A.K. të cilat konsiderohen se i përmbushin dhe kërkesat dhe / ose pretendimet e Ankuesit, të saktësuara në Kërkesën për Rishqyrtim, A.K. do ti inkorporoi në Dosjen e Tenderit në pjesën – Specifikat Teknike si dhe do ti ngritë edhe përmes Platformës Elektronike, me qëllim të informimit të të gjithë O.E. të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit.

Ndërsa sa i përket pretendimit të Ankuesit lidhur me afatin e dorëzimit të informatës shtesë, respektivisht informatës sqaruese, sqarojmë se A.K. menjëherë ka ndërmarrë veprimet e duhura duke kërkuar sqarime nga Njësia Kërkese e A.K. sqarim, dhe synimi ka qenë që brenda afatit më të shkurtër kohor të përgjigjet në kërkesë.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 63 paragrafi 63.1.3. pika (b) të Rregullore Nr. 001/22 për Prokurimin Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 087/2023, datë 11.08.2023

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik


Albanez Tahiraj